

**Ardita REÇI<sup>1</sup>**  
**Arta SAKJA<sup>2</sup>**

## **THE PURPOSE OF TULLIO ERBER'S PUBLICATIONS ABOUT THE ALBANIANS OF BORGIO ERIZZOS IN FAIK KONICA'S "ALBANIA"**

### **ABSTRACT**

The times have dictated the Albanian population to leave their lands and choose survival in other countries. Much less is known about the Arbëreshs of Dalmatia than about the Arbëreshs of Italy, than about the Arvanites of Greece. The object of the study will be a trinity formed by Faik Konica, his magazine "Albania" and researcher Tullio Erber. His work of 1883 "La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara" helps with its originality to set the research questions that will be answered. Based on these circumstances, we consider it correct to raise the hypothesis that Erber's writings were published with the aim of making the Albanian public opinion and the opinion of the main European offices aware that the Albanians were an important factor in the region, not only in their own lands, but also in other countries. neighbors, where they moved and recreated their community life.

In conclusion and for what we presented above, it can be said that the connection of the "triad" Erber-Konica-"Albania" in function of the inclusion of the history, traditions, values and efforts of the Arbëreshs in the colony of Borgo Erizzo to rebuild the new life in the new country and to be included in his life without losing his national features, was in function of building the right Albanian and foreign public opinion that Albanians are an important and constructive factor in the Balkans and Europe. Wherever they have emigrated, they have carried with them high moral, ethical, spiritual and intellectual values, remaining at the same time connected to the history and memories of the country of origin, as a nationality, which should enjoy its natural rights.

**Keywords:** *Faik Konica, Tullio Erber, Albania, Arbëresh, Borgo Erizzo, Zara, Dalmatia.*

---

<sup>1</sup> Dr. Ardita REÇI

<sup>2</sup> Dr. Arta SAKJA

## **QËLLIMSHMËRIA E BOTIMEVE TË TULLIO ERBER RRETH SHQIPTARËVE TË BORGEO ERIZZOS TEK “ALBANIA” E FAIK KONICËS**

### **Abstrakt**

Kohët e kanë diktuar popullsinë shqiptare të linte tokat e veta dhe të zgjidhte mbijetesën në vende të tjera. Për arbëneshët e Dalmacisë dihet shumë më pak se për arbëreshët e Italisë, se për arvanitët e Greqisë. Objekt i studimit do të jetë një trini e formuar nga Faik Konica, revista e tij “Albania” dhe studiuesi Tullio Erber. Vepra e tij e vitit 1883 “La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara” ndihmon me origjinalitetin e vet për caktimin e pyetjeve kërkimore që do t’ju jepen përgjigjet. Nisur nga këto rrethana vlerësojmë të drejtë ngritjen e hipotezës se shkrimet e Erberit u botuan me qëllim për ta ndërgjegjësuar opinionin publik shqiptar dhe opinionin e kancelarive kryesore europiane se shqiptarët ishin faktor i rëndësishëm në rajon, jo vetëm në trojet e veta, por edhe në vendet fqinje, ku u zhvendosën dhe rikrijuan jetën e tyre komunitare.

Në përfundim dhe për sa parashtriam më sipër mund të thuhet se lidhja e “treshes” Erber-Konica-“Albania” në funksion të përfshirjes së historisë, traditave, vlerave dhe përpjekjeve të shqiptarëve në koloninë e Borgo Erizzos për të rindërtuar jetën e re në vendin e ri e për t’u përfshirë në jetën e tij pa humbur tiparet kombëtare, ishte në funksion të ndërtimit të drejtë të opinionit publik shqiptar dhe të huaj se shqiptarët janë faktor i rëndësishëm dhe konstruktiv në Ballkan dhe Europë. Ata kudo ku kanë emigruar kanë mbartur me vete vlera të larta morale, etike, shpirtërore dhe intelektuale, duke mbetur njëkohësisht të lidhur me historinë dhe kujtimet e vendit të origjinës, si një kombësi, që duhet të gëzojë të drejtat e veta natyrore.

**Fjalë kyçe:** *Faik Konica, Tullio Erber, Albania, arbëneshë, Borgo Erizzo, Zara, Dalmaci.*

### **Hyrje**

Prej gati tre shekujsh, në Zarë të Kroacisë jeton komuniteti shqiptar i njohur si “arbënesh”, ndaj të cilëve kanë patur kuriozitet studiues të fushave të ndryshme në shkencat humane. Një ndër ta ishte edhe profesor Tullio Erber, i cili në vitin 1883, botoi në Raguzë veprën e njohur “La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara” (Kolonia shqiptare e Borgo Erizzo-s pranë Zarës). Ky punim i Erberit që ishte sistem referimi për plot kërkues të tjerë mbi gjuhën, traditat, zakonet apo trashëgiminë kulturore të shqiptarëve në Kroaci, në fillim të shekullit të shkuar tërhoqi vëmendjen e Faik Konicës, intelektualit dhe publicistit të shquar të letrave shqipe. Revista e tij “Albania” ishte e njohur tashmë, e megjithatë po kalonte në vështirësi ekonomike. Shkrimet e Erber filluan të publikoheshin në këtë tribunë të shpërfaqjes së intelektualizmit shqiptar, në kohën kur botuesi dhe drejtuesi i saj do të ndryshonte vendqendrimin e tij dhe të revistës nga Brukseli drejt Londrës.

Hapësira, rëndësia që i kushton dhe shtrirja në kohë e temës që rrok Erber, janë burim parësor i këtij artikulli, në fokus të të cilit janë disa objekte, secila ndër më të rëndësishmet në fushën e saj. Së pari, kemi të bëjmë me shkrimet e një prej studiuesve më me autoritet mbi jetesën e komunitetit arbëresh në Zarë të Kroacisë, siç ishte profesor Erber, studiues i historisë së Dalmacisë. Ai kishte realizuar studime arkivore e dokumentare, i frymëzuar edhe nga vlerat e anëtarëve të këtij komuniteti emigrantësh, të shpërngulur në këtë zonë të ish-Mbretërisë Venedikase në shekullin e XVIII. Së dyti, sinteza e studimeve të tij dhe e të dhënave dokumentare vjelë nga arkivat në fundshekullin XIX, u botua në formën e shkrimeve të informative dhe deri diku analitike në vitet 1902-1905 në “Albania”, një prej revistave më me peshë në historinë e shtypit shqiptar, ku trajtoheshin tematika të rëndësishme për ndërgjegjësimin e popullit shqiptar dhe më gjerë. Dhe së treti, “Albania” drejtohej nga Faik Konica, i cilësuar si “Enciklopedia lëvizëse”, një ndër intelektualët më të spikatur shqiptarë, i cili për shkrimet e prof. Erber rezervonte në revistë faqet e para të saj.

Erber ka botuar tek kjo revistë reth 13 artikuj, pjesë të studimit të tij mbi arbëreshët e Zarës, dhe këtë e ka bërë në një prej mediave me më shumë ndikim mbi shqiptarët dhe Shqipërinë, brenda dhe jashtë vendit, e cila botohej në qendër të Europës (fillimisht nga 25 marsi 1897 kur doli numri i parë në Bruksel dhe nga vitit 1902 e deri në botimin e fundit të 1909, në Londër) dhe në kushte të veçanta historike, siç ishte Lëvizja për Rilindjen Kombëtare dhe lëvizjet e popujve ballkanikë për t’u pavarësuar nga Perandoria Osmane. Kur Konica u shpërngul në Londër, mori leje të punonte në Departamentin e Dorëshkrimeve të Muzeumit Britanik. Aty jetoi pesë vjet dhe studioi dokumentet shtetërore veneciane që lidheshin me Shqipërinë si dhe me dorëshkrime të tjera, disa prej të cilave i botoi tek “Albania”. Nisur nga këto rrethana vlerësojmë të drejtë ngritjen e hipotezës se shkrimet e Erberit u botuan me qëllim për ta ndërgjegjësuar opinionin publik shqiptar dhe opinionin e kancelarive kryesore europiane se shqiptarët ishin faktor i rëndësishëm në rajon, jo vetëm në trojet e veta, por edhe në vendet fqinje, ku u zhvendosën dhe rikrijuan jetën e tyre komunitare.

### **Mbi Tullio Erber dhe studiuesit e tjerë të arbëneshëve të Zarës në Kroaci**

Vendbanimi treshekullor i shqiptarëve në Kroaci, është studiuar në shumë plane nga albanologë të shquar. Profesor Aleksandër Stipçeviq thekson:

“Një vëmendje e posaçme e dijetarëve, publicistëve dhe gazetarëve kroatë tërhoqi vendbanimi më i madh i shqiptarëve në bregdetin kroat të Adriatikut – Arbneshë të Zaras.” (Stipçeviq, A. 1991: 169)

Punimin e parë më serioz mbi arbneshët e Zarës, sipas tij, e shkroi drejtori i shkollës normale kroate në Arbënesht, poeti dhe përkthyesi Stjepan Buzolij, i cili e botoi me titullin “Kolendarin popullor të Zarës”. Në veprën në fjalë, autori flet për vendin, zakonet e banorëve të tij dhe historinë e shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë. Në lidhje me studiuesin Erber dhe veprën e tij, profesor Stipçeviq thotë:

“Shumë më i rëndësishëm është punimi i historianit zaras Tulije Arber. Në bazë të kërkimeve të themelta në Arkivin e Zarës si dhe në bazë të tregimit të vetë arbëreshëve, shkroi një studim të themeltë, i cili deri më sot në disa elemente të tij mbeti i pazëvendësueshëm. Autori ia doli të rikonstrukttojë të gjitha ngjarjet kryesore të lidhura për përgatitjen e familjeve shqiptare për vajtje nga vendlindja e moçme, për rrugëtimin e tyre drejt Zarës, si dhe për strehimin e tyre në mjedisin e ri.” (Stipçeviq, A. 1991: 169).

Erber kishte shfitytëzuar një sasi të bollshme dokumentesh, të ruajtura gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX në Arkivin Shtetëror të Kroacisë dhe nëpërmjet analizimit të tyre kishte arritur ta rikonstruktonte jetën e të ardhurëve të parë në rrethinën e Zarës. Siç vërehet edhe më lart, Stipçeviq e ka konsideruar studies kroat dhe mbiemrin e tij e determinon “Arber”. Ndërsa studiues të tjerë profesor Erberin e kanë cilësuar italian, kjo edhe për faktin se studimet e tij i ka publikuar kryesisht në gjuhën italiane.

Njëkohësisht me Erberin dhe pas tij realizuan studime edhe mjaft albanologë të shquar, si linguisti slloven Franc Mikloshiq. Ai kishte vërejtur se në shtëpitë e arbëreshëve flitet ekskluzivisht shqip dhe se fëmijët deri më shtatë vjeç dinë vetëm gjuhën amtare, pastaj në shkollë mësojnë “kroatisht, por edhe italisht, kështu që të gjithë të rriturit flasin të tri gjuhët.”

Një tjetër studiues ishte edhe historiani lokal i Zarës, Carlo Federico Bianchi, me librin “Zara cristiana”.

Me tej është punimi i klerikut dhe muzikanti i shquar Mujo Qurkoviç me titull “Historia e arbëreshëve të Zarës” (Povijest Arbanasa kod Zadra), (Stipçeviq, A. 1991: 170), i bazuar kryesisht në të dhënat e punimit të Erberit, por jo i nivelit shkencor. Ky libërth për një kohë të gjatë në Arbënesht shërbente si burim kryesor i informatave mbi të kaluarën e Arbëneshtit, mbi kishën famullitare dhe mbi njerëzit ca më të njohur të Arbëreshit.

Studimet që u realizuan mbas Luftës së Dytë Botërore, angazhuan kërkues si Vjekosllav Mashtroviqi, i cili në nuk ka shkruar asnjë punim të veçantë mbi këtë temë, por në disa punime të tij ka përmendur njerëz dhe ngjarje të ndodhura në Arbënesht të Zarës (Stipçeviq, A.1991: 171). Kontribut të rëndësishëm për njohjen e arbëreshëve të Zarës dhe të albanologjisë ka dhënë filologu, psikologu dhe leksikografi Dr. Kruno Kërstiqi, që ishte edhe pjesëtar i komunitetit arbëresh të Zarës, duke shfrytëzuar gjithashtu si Erber, pasurinë e Arkivit Shtetëror të Zarës dhe dokumentet e ruajtura aty që flasin për ardhjen e arbëreshëve në Zarë. Së pari ai shkroi një artikull, me rastin e 225-vjetorit të fillimit të kësaj shpërnguljeje për gazetën “Gllas Zadra”, një shkrim ky i gjatë dhe i detajuar. Kërstiq është i njohur për hartimin e “Fjalorit të të folmes së arbëreshëve të Zarës”, ku ka përfshirë rreth 4000 fjalë, që përdoren nga ana e arbëreshëve të Zarës (Stipçeviq, A. 1991: 172). Një tjetër autor arbëresh i Zarës, Niko Karuçi, është bërë gjithashtu i njohur fillimisht nga shkrimet e tij në gazeta profesionale dhe të komunitetit arbëresh të Zarës si “Gllas Zadra”, “Zadarska revija”, dhe në përmbledhësin “Uçiteljska škola Zadar 1866-1956” (Shkolla normale e Zarës 1866-1956). Ky autor fokusohet në tematikën e historisë më të re të arbëreshëve (Lëvizja punëtore “Hrvatska pučka knjizhnica”. Biblioteka popullore kroate; Stacioni bujqësor në Arbënesht, Stjepan Buzoliqi dhe arbënesht, etj.). Ai ka dokumentuar në shtyp kujtimet e veta për njerëzit dhe ngjarjet nga koha para dhe pas Luftës së Parë Botërore. Gjithashtu i njohur për artikujt e tij mbi gjuhën e arbëreshëve të Zarës është edhe autori arbëresh i Zarës, mësuesi Budimir Peroviqi. Punim interesant ka patur edhe Ante Maria Strgaçiqi, që në bazë të dokumenteve, që ruhen në Arkivin Shtetëror të Zarës, paraqiti të dhëna për përpjekjen e botimit të gazetave në gjuhën arbëreshe në vitin 1897. E po ashtu edhe Josip Marushiqin (Beppo Marussi), që ba shkruar rreth njëzet artikuj mbi ngjarjet në Arbënesht, mbi zakonet popullore, mbi Stacionin Bujqësor në Arbënesht, mbi shkollën normale kroate etj, të publikuara në gazetat dhe revistat irredentiste (“Zara”, “Difesa adriatica”, “La Rivista dalmatica”). Tek një prej shkrimeve të këtij autori, që flet për Shkollën Normale, reflektohet edhe vizita e politikanit e shkrimtarit Fan Noli tek arbënesht në vitin 1913 dhe mbi vizitën e delegacionit të arbëreshëve të Zarës, në të njëjtin vit, në Shqipëri. Gjithashtu janë të shumtë autorët që kanë shkruar artikuj gazetareskë mbi Arbëneshtin dhe Arbënesht (Stipçeviq, A. 1991:173). Ndërsa në shekullin XX profesor Stipçeviq është një ndër autoritetet e kërkimit shkencor mbi historinë, gjuhën dhe kulturën e këtij komuniteti. Ndër më të njohurit e kohëve të fundit është libri “Tradiciska kultura Zadarskih Arbanasa“ (Kultura tradiconale e Arbëreshëve të Zarës). Në këtë punim jepen të dhëna të plota mbi tri fazat kryesore të shpërnguljes së fiseve shqiptare në lagjen e

Zarës së emërtuar “Borgo Erizzo”, për nder të princit venedikas që i kishte nën zotërim këto toka dhe u hapi dyert shqiptarëve të krishterë nga fshatrat e Shkodrës. Stipçeviq, ashtu si edhe Erber, u referohen të njëjtave burime arkivore, edhe pse në kohë të ndryshme, e ndaj e citon atë.

“Sipas dokumenteve që ruhen në Arkivin Historik të Zarës, kjo lagje, nga popullsia kroate, në fillim u njoh me emrin Eriçin Varosh (Ericovo Selo), e më vonë edhe Abanasi, dhe Arbnesht, nga vetë banorët shqiptarë. Në vitin 1721, nga fshatrat rreth Liqenit të Shkodrës - Brisk, Shestan e Larje - u shpërngulën 32 familje shqiptare me 227 frymë dhe u vendosën në paralagjen e Zarës, që u quajt Borgo Erizzo, sipas providurit general për Dalmaci e Shqipëri, Nikolla Erizo.” (Dervishi, N.: 286)

Duket se emigrimi i shqiptarëve drejt këtyre viseve kroate ka qenë i menduar më parë. Sipas studimeve të Stipçeviq:

“Iniciator kryesor për këtë shpërngulje ishte argjipeshkvi i Zarës, Visk Zmajeviq. Është mjaft indikative një marrëveshje sekrete në mes Zmajeviqit, përfaqësuesve sllavë dhe Venedikut, e vitit 1713, në të cilën vendoset që të shpërngulen shqiptarët rreth Liqenit të Shkodrës dhe të Shqipërisë Veriore. Tokat e të shpërngulurve do t’u ndaheshin serbëve, ndërsa shqiptarët do të vendoseshin në Zarë, në afërsi të Pulës dhe qyteteve të tjera bregdetare dalmatine. Përveç shpërnguljes së vitit 1721, kemi dhe tri shpërngulje të tjera të rëndësishme të shqiptarëve në Arbënesht në vitet 1726, 1727 dhe 1733. Pas këtyre shpërnguljeve, kemi edhe disa të tjera, por janë më të vogla. Numri i familjeve të shpërngulura është me qindra, kurse frymët janë me mijëra.” (Dervishi, N.: 286)

### **Interesimi i Konicës për Arbënesht e Zarës**

Përfshirja e Arbëneshtëve të Zarës në ngjarjet politike të fundshekullit XIX dhe fillimi i atij XX, rezultoi me publikimin e një numri të madh artikujsh në gazetatat kryesisht të Zarës, që flisnin mbi të shkruarën e tyre. (Stipçeviq, A. (1991: 71) Pra shtypi lokal tashmë ishte konsoliduar dhe kishte një traditë të mirë të reflektimit mbi identitetin kombëtar të kësaj kolonie shqiptare. Por, në veprën e mësipërme, të Stipçeviq theksohet se:

“Për një kohë të gjatë pas vendosjes, arbëneshtët nuk kanë pasur kurrfarë lidhjesh me atdheun e vjetër. Vetëm kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i atij XX, arbëneshtët e Zarës shfaqin interesim për ngjarjet në Shqipëri, por njëkohësisht disa personalitet të shquara publike dhe politike nga Shqipëria gjithnjë e më tepër u kthehen arbëneshtëve dhe e theksojnë vendosjen e lidhjeve ndërmjet atdheut të vjetër dhe banorëve të Arbëneshtit.” (Shema, I: ExLibris).

Këtu merr vlerë dhe veçohet vëmendja e Faik Konicës dhe veprimtaria e tij në Zarë dhe midis arbëneshtëve. Profesor Isak Shema ka publikuar përmbajtjen e një dokumenti të gjetur në Arkivin

e Vjenës më 28 maj 1978, dorëshkrim në gjuhën frënge i emërtuar: “Parashtresë mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”. Teksti i shkruar në vitin 1899 në Bruksel, ka 84 faqe dhe i është dërguar Ministrisë së Jashtme të Austrisë. Shkrimi ndahet në pesë pjesë dhe përfshin periudhat historike të Lëvizjes Shqiptare: pjesa e parë deri në vitin 1877, ndërsa tri të tjerat deri në vitin 1899. Në pjesën e fundit përfshihen emrat e personaliteteve të shquara të Lëvizjes Kombëtare (Shema, I: ExLibris). Aty përmendet edhe emri i Konicës, që edhe sipas dëshmive të Stipçeviqit, e kishte vizituar katër herë Arbëneshin, në kuadër të lëvizjeve kombëtare për pavarësi. Por prap, sipas profesor Shemas, “Veprimtaria e tij në koloninë e arbëneshë më parë nuk është ndriçuar sa duhet.” Në përmbajtjen e dokumentit të cituar më sipër, shënohet:

“Në atë kohë arriti në Arbënesh një “filolog”, siç e quante policia e fshehtë austriake. Kjo polici sekrete e gjithëdijshme kishte marrë vesh se nga ai “filolog” kishte rrjedhur ideja që në Arbënesh të fillonte botimi i gazetës në gjuhën shqipe, e cila do t’u shërbente si burim i informatave jo vetëm arbëneshëve të Zarës, por edhe të gjithë shqiptarëve në gjithë Shqipërinë, pastaj atyre në Itali dhe në vendet e tjera ku jetonin ata. Gazeta do të kishte titullin “Zani i Šcyptarit”, kurse nismëtar e kësaj ndërmarrjeje ishin: Mijo Çurkoviqi, Petar Marushiçi, Kërsto Stipçeviqi dhe Luçi Pavao Rela.” (Stipçeviq, A., 1991: 71)

Me sa më sipër kuptohet se qëllimet e Konicës ishin të ndërtonte mjetet e komunikimit masiv të identitetit kombëtar të Arbëneshëve, gazetatat dhe format tjera të shpërfaqjes së tij, të cilat gjithashtu ishin një ndër mjetet më të fuqishme të kohës për zgjimin e kombit dhe mobilizimin e tij rreth lëvizjes për mbrotjen e çështjes kombëtare, e nga ana tjetër mjeti më i fuqishëm për ndërtimin e opinionit publik mbi imazhin dhe autoimazhin e kombit shqiptar.

### **Lëvizjet për Rilindjen Kombëtare të Arbëneshëve të Zarës dhe hapësia e kushtuar në faqet e “Albania”**

Në kuadër të veprimtarive patriotike dhe kulturore edhe arbëneshë janë përfshirë në shumë ngjarje gjatë lëvizjes për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, të cilat janë pasqyruar edhe në shtypin periodik të kohës, që trajtonte si problemet aktuale shoqërore, por edhe ato politike dhe kulturore. Ashtu si edhe koloni të tjera shqiptare të shpërndara në diasporë, edhe tek arbëneshët mendimi shoqëror dhe politik i Rilindjes kishte depërtuar, duke nxitur aktivitete kulturore dhe shoqërore me jehonë të theksuar patriotike:

“Mësimi i gjuhës shqipe, njohja e historisë dhe e kulturës shqiptare, ka forcuar rezistencën kombëtare dhe ka penguar, aq sa ka qenë e mundshme, përçarjen kombëtare, dominimin e rrymave të huaja politike dhe asimilimin.” (Shema, I: ExLibris)

Një ndër format e realizimit të përfshirje në të tilla lëvizje të mëdha historike, është edhe njohja me të kaluarën e kombit, ndaj dhe Konica i kushtoi rëndësi të dorës së parë përkthimi dhe botimi të veprës së Erber “*La colonia albanese di Borgo Erizzo preso Zara*”, 1883 (“Shcyptaret e Borgo-Erizzos”) në revistën “Albania”, ku vend të rëndësishëm në këtë revistë zinin gjithashtu edhe botimi i poezisë popullore, i materialeve folklorike nga Arbëneshi, shkrime mbi gjuhën, historinë dhe kulturën e shqiptarëve të Zarës, të cilat gjithashtu u bënë të njohur opinionit publik të Londrës e të kancelarive të tjera europiane, po aq sa atij shqipfolës të shkuarën dhe kulturën e ruajtur nga ky komunitet shqiptar. Studiuesit Hamit Boriçi dhe Mark Marku cilësojnë se:

“Faik Konica, që ishte një nga shkrimatrët dhe publicistët më të talentuar të kulturës shqiptare, i cili me personalitetin dhe prirjen e tij përcaktoi edhe natyrën e revistës: si një revistë krejt e ndryshme nga ato që botoheshin në Bukuresht, në Stamboll, Sofje apo Kajro, qoftë nga ana e paraqitjes grafike, po ashtu edhe nga përmbajtja. Shumë shpejt, revista u bë një nga organet më të njohura dhe më me ndikim në gjithë historinë e shtypit shqiptar që, në saje të rrethanave historike, zhvillohej jashtë trojeve amtare.” ( Boriçi, H. & Marku, M., 2010: 150)

“Albania” ishte revistë e përmuajshme fillimisht, por në vitin e dytë e ndryshoi përkohshmërinë e botimit në të përdyjavshme me format të zvogëluar. Dora e Konicës dhe fryma e tij dallohet në një pjesë të mirë të materialeve të botuara, të cilat mbajnë firmën e tij apo pseudonimin Thrank Spiro Beg. Në 24 faqet e brendisë së saj përfshiheshin rubrikat: “Të rejat”, “Kujtime”, “Gjuha”, “Kombësia”, “Shkenca”, “Çështje të gjuhës dhe mendime të vogla”, “Nëpër fletoret shqipe”, “Epigrame”, “Libra të rinj”, “Shënime”, “Kreshpëendecë (letra)”, “Bibliografi”, “Tej e këtej”. Nga viti 1902 deri në 1905, në numrat ku botohej studimi i Erberit, mund të thuhet se trajtohej si rubrikë e veçantë dhe u rezervoheshin faqet e para të numrit në botim. Titujt e tyre ishin si më poshtë:

1. Shcyptart e Borgo Erizzos (I. T’ardhunit e pare n’vjete 1726), Vol.G,VI 1902, Nr. 3.
2. Shcyptart e Borgo Erizzos (I. T’ardhunit e pare n’vjete 1726), Vol.G,VI 1902, Nr. 4.
3. Shcyptart e Borgo Erizzos (II. Kanuni i Shcyptarve), Vol. G, VI/1904, Nr. 5.
4. Shcyptart e Borgo Erizzos (III. T’ardhunit e dYTE n’vjete 1727), Vol.G,VI/1902, Nr.6.
5. Shcyptart e Arbneshtvet (IV. Shcyptart deri n’vjete 1733), Vol. G, VI/1902, Nr.8.
6. Shcyptart e Arbneshtvet (V. T’ardhunit e trete n’vjete 1733), Vol.G,VI/1902, Nr.10.
7. Shcyptart e Arbneshtvet (VI. Toke ci u kiesen dhanun Shvyptarve ci erdhën n’vjete 1733), Vol.H, VII/1903, Nr.4.



8. Shcyptart e Arbneshtvet (VII. T'shcyptarvet e t'bahtun shpitiash shcyptare), Vol. H, VII/1903, Nr.5.
9. Shcyptart e Arbneshtvet (VIII. T'nertuemt e kishes), Vol. I, VIII/1904, Nr.2.
10. Shcyptart e Arbneshtvet (IX. T'nnollunat e Shcyptarvet deri n'vjet 1759), X. T'parat sheje tregtiet e mjeshtriet n'Arbneshe, XI. Shtetesii e Arbneshtve). - Vol. I, VIII/1904, Nr.5.
11. Shcyptart e Arbneshtvet (XII. Katunnet e Shcypniis, preje t'tsilash u-bajte Shcyptaret e Arbneshtvet). - Vol. I, VIII/1904, Nr.7.
12. Shcyptart e Arbneshtvet (XIII. Shpia e vennse, XIV. Mjeshtrie e tregtie), Vol. I, VIII/1904, Nr.10.
13. Shcyptart e Arbneshtvet (XV. Komsii e ghuhe), IX/1905, Nr

Që në renditjen e temave të nënkuptuar në tituj, kuptohet se Erber ka përzgjedhur trajtesën kronologjike të historisë së shpërnguljes dhe konsolidimit të kolonisë shqiptare në Borgo Erizzo. Në dy shkrimet e para publikohen dokumentet arkivore që vërtetojnë shpërnguljen, në hapësirën territoriale të përcaktuar me përshkrimet e hartave lokale si dhe listat e familjeve të shpërngulura. Erber thekson menjëherë edhe elementin e stilizimit të emrave apo mbiemrave sipas modelit kroat ose italian, të cilat janë një ndër të parat shenja për përshtatjes formale me vendbanimin e ri.

“Ajo çfarë i shtyu shqiptarët në një azil të vetëdëshiruar dhe që i bëri të linin çfarë kishin më të dashur ishin pikërisht persekutimet fetare dhe keqtrajtimet nga ana e turqve. Duhet të kishin qenë trajtuar me të vërtetë keq, në se këta individë të rritur në male e linin vullnetarisht tokën e të parëve të tyre, ku çdo shkëmb ishte bërë i pavdekshëm nga lavdia dhe gjaku i tyre, për të kërkuar një fat të pasigurtë në një vend të huaj. Te njëjtat dokumenta na thonë se këta shqiptarë të parë të ardhur për të banuar në afërsitë tona, nuk ishin proletarë të varfër, pa shtëpi dhe pa bukë, që iknin nga vendi i tyre për të kërkuar një fitim të lehtë. Ishin fshatarë me një shkallë të caktuar mirëqënieje, të cilët të fyer në fe dhe ndofta akoma më shumë në nder, të persekutuar nga cmira otomane kishin ardhur nën mbrojtjen e Republikës Veneciane për t'i kërkuar kësaj të fundit as qetësi dhe as lëmoshë, por tokë që ta punonin dhetë jetonin ndershmërisht.”,

shkruhet në numrin e tretë të “Albanias” së vitit 1902. Marrëdhënia e mirë më klerin katolik ndikoi që drejtuesit e tij t'u falnin tokat e zonës së Zemonikës pranë Zarës, toka që në fakt ishin lënë djerrë më parë nga vendasit dhe me punimin e të cilave shqiptarët do të fitonin jetesën, duke qëndruar në këtë mënyrë edhe të bashkuar rreth saj, në komunitet.

Në numrin e dytë lexojmë se atyre u ishin krijuar kushte të privilegjuara; sepse duke qenë në fusha prodhimtare siç janë ato të Zemonicos, duke pasur një kopësht ngjitur banesës dhe shtëpi të mëdha dhe komode (nga harta del se secila nga të 16 shtëpitë ndërtaur nga shteti venecian përbëhej nga tre godina; një për banimin e njerëzve dhe dy për mbajtjen e bagëtive dhe të prodhimit (grurit,

ushqimeve apo bulmetoreve të ndryshme), shqiptarët mund brenda një kohe shumë të shkurtër të arrinin një shkallë të konsiderueshme mirëqenieje.

Në rastin e kësaj kolonie shumë shpejt mbas emigrimit dhe ngulimit në vend të huaj, ata fillojnë të fitojnë të drejta të derivuara nga prijësi i vendit dhe këtë Erber e pasqyron duke iu referuar burimeve arkivore. Në shkrimin e tretë të titulluar “Kanuni i Shqiptarëve”, po të gjykojmë mirë Erber e parashtron argumentin, nisur nga të dhënat empirike antropologjike të shqiptarëve: nga natyra e ashpër dhe shumë krenare, që karakterizon edhe sot e kësaj dite këtë popull, e shohim të natyrshme gatishmërinë e administratorit të përgjithshëm Erizzo II, që i dha krahinës në 15 gusht të vitit 1726 një kushtetutë që duhet të shërbente për të mbajtur rregullin dhe qetësinë.

Kushtetuta në fjalë ishte hartuar në mënyrë të thjeshtë por të mençur sipas Erber, pasi parashikonte me shumë mënjori të gjitha pakënaqësitë që mund të lindnin. Ndër të tjera, në të u njëhej shqiptarëve e drejta të zgjidhnin vetë nga anëtarët e kolonisë një kryetar a kapiten, i cili duhej të konfirmohej nga administratori i përgjithshëm.

Një prej shkrimeve për këtë komunitet është ai që lidhet me dokumentimin e ndërtimit të kishës. Nga historia e arbëreshëve të Italisë së Jugut studiuesit e historisë dhe të etnografisë kanë vënë re se kisha dhe ritualet fetare kanë qenë një ndër elementet më të forta që kanë mbajtur të lidhur komunitetin, i cili më tej edhe gjatë veprimtarive të tjera të përbashkëta ka rigjeneruar vazhdimisht kulturën e vendit të origjinës. Fshatarët shqiptarë të Borgo Erizzos, që tashmë ishte një fshat i populluar dhe me njëfarë mirëqenieje ekonomike, iu drejtuan kryepeshkopit Zmajević duke iu lutur që t’u siguronte një kishë dhe një prift, duke i premtuar që në të ardhmen do të kontribonin edhe vetë për mbajtjen e kishës me një pjesë të prodhimeve. Dhe Zmajević zgjodhi një prift që e njihnte shqipen dhe pastaj i kërkoi senatit venecian, të drejtën për të ndërtuar me shpenzimet e veta një kishë. E drejta, sipas Erberit, iu dha me datë 17 shtator 1735. Ndërtesa e kishës së kushtuar Shën Marisë së Loretës, ishte e thjeshtë, në formë katrore, pa ndonjë arkitekturë të veçantë, por e fortë dhe e ndërtuar me gurë të rregullt.

Në shkrimet vijuese paraqiten problemet e konsolidimit të statusit ligjor e qytetar, të drejtat e tjera për përdorim të territorit, ujërave, taksat etj. Me rëndësi të veçantë është shkrimi që lidhet me shtëpitë e shqiptarëve në Zarë. Sipas përshkrimeve të Erber, shtëpitë e shqiptarëve të para nga rruga nuk kanë asgjë të veçantë:

“... por duke qenë se janë larg nga njëra-tjetra mund të ndahen në tre kategori: në grupin e parë bëjnë pjesë ndërtesat e ndërtuara me një farë luksi, të stilit qytetar dhe që i përkasin

kohëve të fundit. Në grupin e dytë futen më pak shtëpi, por këto janë ato që paraqesin interesin më të madh për ne, sepse u ndërtuan nga Republika Veneciane. Janë shtëpi njëkatëshe bashkë me ca ndërtesa dytësore, që shërbenin edhe për të mbajtur veglat e punës, prodhimet dhe kafshët. Të gjitha shtëpitë dallohen për një rregullsi totale, për përdorimin e harkut në arkitekturë dhe një formë pak a shumë komplekse, që të kujton dashje pa dashje shtëpitë e fshatarëve venecianë. Në grupin e tretë bëjnë pjesë disa kasolle të varfra, që të kujtojnë ato të pjesës më të madhe të fshatarëve të këtyre zonave. Këto shtëpi iu përkasin për më tepër fëmijëve që duke u ndarë nga prindërit, nisën gjithçka nga fillimi këtu, pa pasur ndonjë pasuri fillestare. Megjithatë në përgjithësi fshati i Borgo Erizzos është i bashkuar dhe po ta shohësh të tërin dhe të gjitha shtëpitë bashkë të lënë përshtypjen e mirë të një fshati me një gjendje ekonomike të kënaqshme dhe relativisht progresiv. Çdo shtëpi, edhe më e varfëra ka kopështin e vet të kultivuar me shumë kujdes, gjë që tregon edhe një nga aktivitetet e banorëve.”

Po në këtë shkrim Erber bën dhe një përshkrim të tipareve fizike të shqiptarëve, duke theksuar se shqiptarët nga ana e jashtme nuk dallojnë fare me fshatarët e tjerë të vendeve fqinje:

“Të gjithë kanë adoptuar mënyrën sllave të të veshurit, por dallohen për më shumë shije në të veshur, si femrat, ashtu dhe meshkujt. Që kur vjen për herë të parë në Borgo Erizzo e dallon qartë që banorët nuk janë sllavë, sepse në kundërshtim me sjelljen e rëndë, hundën e shtypur dhe ngjyrën e zverdhur të mollzave që karakterizon sllavët, ata janë të ushqyer mirë, me një ngjyrë të shëndetshme dhe një sjellje të shkujdesur. Shqiptarët kanë një pamje shumë burrërore dhe të shikojnë me atë sinqeritet që të thotë që në fillim. Sanguinë dhe krenarë si natyrë, nga ana tjetër janë të dashur dhe besnikë kundrejt atyre që i trajtojnë mirë deri në atë pikë sa të rrezikojnë gjithçka, edhe jetën, për të shpërblyer një mirëbërës.”

Janë të shumta mahnitë që Erber shfaq nga kundrimi i përfaqësuesve të popullit shqiptar:

“Shqiptarët megjithëse të fortë mund të quhen trupbukur; dhe zgjuarsia ju duket që nga sytë, aq shprehës deri tek e folura dhe e sjellura aq e shkujdesur. Kundrejt shqiptarëve pastaj, Zoti është treguar shumë mëshirëmadh dhe i drejtë, sepse ju dha gra që t’u përgjigjeshin shkëlqyeshëm burrave të tyre. Asnjërit që ka vizituar me kujdes këtë vend nuk ka mundësi t’i kenë shpëtuar pa parë dhe tërhequr vemendjen ato fytyra faqekeqe me linja të përcaktuara qartë dhe shumë shprehëse; asnjëri nuk mund të ketë ndenjor indiferent dhe pa admiruar linjat e përsosura të shqiptarëve, që aq të bukura të shikojnë një herë shkarazi dhe pastaj kthehen në punët e tyre. Mund t’i shikoni të mbushin ujin tek burimi ose të shtyjnë kafshët e punës. Shpeshherë është e vështirë të kuptosh sesi këtyre grave kaq të ekspozuara ndaj rrezeve të diellit dhe punëve më të vështira nuk u ngelet as gjurma më e vogël e gjithë kësaj në format, ecjen apo lëvizjet. Midis grave të martuara është pak më e vështirë të gjesh një fytyrë po kaq të bukur; ato jepen komplet mbas rritjes së fëmijëve dhe me shtimin e punëve dhe lodhjeve, ato e lënë mënjandë veshjen, pamjen e jashtme dhe plaken para kohe. Kjo natyrisht nuk është veti e racës shqiptare, përkundrazi, gratë shqiptare nëse nuk vuajnë për bukë dhe nuk iu duhet të përmbushin detyrat e vështira të fushës, i mbajnë shumë mirë vitet ndonëse nuk bëjnë ulje moshash, siç ndodh shpesh me damat e qytetit. Ka dhe disa plaka të shëmtuara, po aq të shëmtuara, sa po të mos ishte

respekti për moshën që ta ndalonte, do t'i quaje shtriga. ... Por nga fakti se shqiptarët me goditje kazme dinë të zbusin tokën e fortë të Dalmacisë, nuk duhet të besojmë se ata janë të heshtur dhe të mërzitshëm. Përkundrazi, po të përshkoni Borgo Erizzon gjatë mbrëmjes, mbasi të gjithë kanë mbaruar punën ose në ditë feste, do të dëgjoni këngë të lumtura nga të gjitha anët. Ditët familjare të shënuara ose festat kishtare, varrimet ose banketet e lumtura, shoqërohen gjithmonë nga këngë melodioze, që të prekin në zemër. Ata kanë një vesh shumë të rrallë për muzikën dhe koret e tyre janë me të vërtetë të mrekullueshëm. Është shumë e çuditshme se si burra që nuk kanë asnjë ide të muzikës së mësuarnepër libra arrijnë t'i alternojnë zërat aq mirë, altot dhe basot, të parin dhe të dytin. Jam i bindur se po të shkonin të bënin një xhiro nëpër botë nuk do të kishin më pak sukses se këngëtarët tirolezë. Edhe gratë janë të prera në të kënduar dhe e dinë këtë; sepse kur kthehen nga puna kumbojnë me këngët e tyre harmonioze për më tepër nëse shohin qytetarë të afrohen. Dhe është e çuditshme që një popull kaq muzikor nuk ka ruajtur këngë të vetat dhe këndon këngë sllave dhe disa italiane. Mbase shkak i kësaj duhet të kërkohet në historinë e tyre dhe më saktë në persekutimet që kanë vuajtur për shumë e shumë vjet në atdheun e të parëve. Turqit kanë pasur kudo aftësinë të zhdukin dhe të shuajnë këngët kombëtare dhe t'i zëvendësojnë ato me një heshtje varri.”<sup>3</sup>

Sa u përket ndjenjave të përkatësisë kombëtare, Erber shkruan se megjithëse në vend të huaj ata kanë ruajtur të gjallë ndjenjën e nacionalitetit dhe për të janë krenarë:

“Ndjenjës nacionale shpesh herë i ndërhyjnë ndjenja e ndarjes; ata mund të jenë kroatë, ose autonom në politikë, por në zemër janë gjithmonë shqiptarë dhe duan më tepër se çdo gjë të dëgjojnë të flitet për bashkatdhetarët e tyre. Të gjithë shqiptarët njohin përveç gjuhës së tyre edhe italishten dhe sllavishten. Italishtja ju shërben për kontratat me qytetarët, ndërkohë që zona rreth e rrotull flet sllavisht, dhe ata kanë për këtë gjuhë një dobësi dhe e flasin në përgjithësi më mirë se e para. Shqiptarët me të vërtetë e kanë kundërshtuar me forcë futjen e gjuhës glagolite në meshën e fshatit dhe as duan ta dëgjojnë as sot e kësaj dite duke e konsideruar si një gjë të urryeshme që duan t'ia imponojnë një pakice kroate.”

Ndërsa për gjuhën shqipe, në fund të shekullit XIX thotë se e ruanin relativisht mirë, duke marrë parasysh vështirësitë e ndryshme që kanë kaluar si dhe faktin se shkolla, librat dhe shtypi në gjuhën amëtare mungonin. Për të provuar ruajtjen e gjuhës, publikohen edhe format ekzistuese të komunikimit në shqip, të krahasuara me gjegjësen e vet të origjinës. Vëmendja e Konicës për arbëneshët në këto vite të botimit të “Albanias” nuk kufizohet vetëm në publikimin e pjesëve të studimit të Erber. Aty botohej edhe rubrika e rëndësishme “Zani préje arbnëshvét”. Kjo rubrikë shërbente si një tribunë për pasqyrimin e aktiviteteve kulturore dhe emancipuese që realizoheshin për arbëneshët në Zarë, duke filluar që nga aktivitetet e grupeve diletante artistike, të cilat shfaqnin

---

<sup>3</sup> Shënim: për lehtësi leximi të lexuesit të sotëm të gjuhës standarde shqipe, por edhe të variantit të sotëm të shkruar geg, të ndryshëm nga ai i përdorur në shkrimet origjinale tek “Albania”, autoret i referohen tekstit të publikuar në revistën “Përpjekja” të Fatos Lubonjës, në numrin e nëntë të saj, viti 2011, në faqen 88 e në vijim.

pjesë teatrore dhe programe të ndryshme artistike muzikore, e deri tek tubimet e realizuara pranë “Leximores së Arbëneshit”, pranë të cilës u afruan edhe shoqëritë kulturore dhe artistike, siç ishte Shoqëria “Arbanasi” (“Arbëneshi”).

Revista “Albania” pati ndikim të madh veçanërisht në jetën kulturore e politike të shqiptarëve, pasi ndër të tjera ishte organi i parë që siguroi bashkëpunimin e figurave më të rëndësishme të kulturës shqiptare, nën orientimin e Konicës, që “artikujt të jenë të ndarë nga njëri-tjetri, të jenë me abc të përdorur në “Albania” a të paktën të “Bashkimit”, të mos kenë fjalë turqisht”, etj.: (Boriçi, H. & Marku, M., 2010: 152). Sipas Boriçit dhe Markut, “Albania” arriti të shpërndahej dhe të ndikonte në të gjitha kolonitë e territoret, dhe në të gjitha grupet politike e kulturore shqiptare, duke pasur si model shtypin francez dhe atë anglez. Ajo ishte një organ mediatik modern, krejt i ndryshëm nga pjesa tjetër e shtypit që ishte botuar deri atëherë prej botuesve shqiptarë në Stamboll, Bukuresht apo Sofje. Ky model u ndoq më pas edhe nga shtypi shqiptar i botuar në SHBA. Studiuesi Jorgo Bulo në konceptimin e zërit të kësaj reviste për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar thekson:

“Albania” u dha vend të gjerë çështjeve politike e letrare, materialeve folklorike e çështjeve etnologjike, artikujve e dokumenteve për historinë e Shqipërisë, për traditat dhe kulturën e popullit shqiptar. Ajo u bë kështu një farë enciklopedie që vinte në qarkullim një informacion të pasur kulturor, shkencor e historik.” (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, AShSh, Tiranë, 2009.)

Aty theksohet se shkrimet me karakter politik, historik e kulturor, të botuara edhe në frëngjisht, ndihmuan të bëhej e njohur çështja shqiptare në rrethet e huaja shkencore e kulturore. Gjithashtu revista përuroi kritikën letrare shqiptare duke botuar shkrime e recensione për vepra e autorë shqiptarë dhe arbëreshë, midis të cilave spikasin gjykimet e mprehta kritike të drejtorit të saj. “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, AShSh, Tiranë, 2009)

### **Konsiderata për Konicën dhe qëllimshmëria e publikimit të shkrimeve të Erber**

Një ndër teoritë më të cituara në shkencat e komunikimit, përsa i përket krijimit dhe përdorimit të imazhit në situata komunikative, është ajo e Erving Goffman, që e konsideron komunikimin e të përditshmes si një vënie në skenë, njerëzit (komunikuesit) si aktorë, që, nëpërmjet performancës së tyre përpiqen të krijojnë përshtypje tek audienca. Kështu, sipas Goffman (Goffman, E. 1959):

“Zakonisht kur një individ thotë diçka, ai nuk po e thotë atë si një pohim të thatë faktik. Ai po inskenon diçka. Ai po përshkon një sërë ngjarjesh të paracaktuara për angazhimin e dëgjuesëve të tij”.

Këtë angazhim të audiencave të tija kërkonte dhe publicisti i madh shqiptar Faik Konica, kur përpiquej të krijonte autoimazhin dhe imazhin e shqiptarëve në botë.

Shqiptarët kanë filluar të mendojnë vonë për krijimin e asaj që në imazhologji quhet autoimazh. Në fakt imazhi i vërtetë i një vendi, kulture apo populli krijohet në një lojë force mes imazhit dhe autoimazhit. Imazhologjia, sipas përcaktimeve të studiueses Nora Moll, është studimi i imazheve, paragjykimëve, klisheve, stereotipeve dhe në përgjithësi i opinioneve për popuj e kultura të tjera që transmetojnë shkrimet e ndryshme duke u nisur nga bindja se këto imazhe siç quhen zakonisht, kanë një rëndësi që shkon përtej rëndësisë që kanë si fakte letrare të thjeshta. Interesi më i madh për studimet imazhologjike buron nga fakti se këto imazhe kanë edhe një vlerë ideologjike dhe politike. Duke qenë, jo vetëm publicist, por njohës i mirë i politikës ndërkombëtare, Faik Konica, e dinte fare mirë se mënyra se si ne e shohim veten, formëson ndërveprimin tonë me të tjerët. Pra servirja më e mirë e imazhit tonë për veten, do të ndikonte pozitivisht në pozicionimin dhe trajtimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Studiuesi arbëresh i historisë së letërsisë dhe të popullit shqiptar i fillimshekullit të shkuar, Gaetano Petrota, në veprën e tij voluminoze “Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare”, botuar në Palermo në vitin 1932, ka këto konsiderata për Konicën:

“Shkrimtar penëhollë dhe me kulturë, polemist i fortë, gojëtar dhe politikan, Faik Konica është një prej figurave më interesante që spikasin në politikën, letërsinë, shtypin shqiptar dhe prej më tepër se një tridhjetëvjetëshi. Të shumë janë admiruesit e Konicës, i cili megjithatë ka pasur edhe kundërshtarë të fortë për shkak të natyrës së tij të rrëmbyer, të egërsisë së polemikave të tij, të satirës therëse të tij, të shpirtit thumbues të tij. Por të gjithë janë një mendje të pranojnë se Faik Konica ka drejtuar forcën e mendjes së lartë të tij dhe i ka kushtuar vetveten çështjes shqiptare qysh në vitet e para të rinisë së rrëmbyer të tij.” (Petrota, G., 2008: 348)

Në moshë të re, vetëm 22 vjeç, dhe pasi kishte përvetësuar njohuri në disa disiplina dhe njihte pothuaj të gjitha gjuhët e Europës, publikon numrin e parë të “Albanias”. Në nëntor të vitit 1912 Konica shkoi në Londër si delegat i ‘Vatërës’ në Konferencën e Ambasadorëve për krijimin e shtetit shqiptar. Ai që zgjedhur kryetar i Kongresit Shqiptar të Triestes (mars 1913) dhe i ngarkuar prej gjithë delegatëve të mbledhur atje, ai zhvilloi në atë kohë bisedime të rëndësishme me kontin

Berthold, ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë, dhe me markezin San Xhuliano, ministër i Jashtëm i Italisë, dy fuqive më të interesuara për rregullimin e Shqipërisë.

Gazeta Shqiptare e Barit e 25 dhjetorit 1928, shkruante për të se po kthehej nga një udhëtim në Shqipëri Faik Konica, i cili “nuk ka nevojë t’u prezantohet lexuesve”. Burrë shteti në kuptimin e njëmendët të fjalës, ai ka përfaqësuar atdheun në Shtetet e Bashkuara për shumë vite... ky burrë ka luftuar me gjithë shpirt për lirinë kombëtare, qysh në agimet e ekzistencës sonë dhe nga fillimi i autonomisë sonë e i Rilindjes Kombëtare të popullit shqiptar. Të gjithë atdhetarët do ta sjellin ndërmend bashkëpunimin e zotëri Konicës me një grup prej atyre që tashmë mund të quhen veteranët e kombit... bibliografia e zotërisë Faik Konica nuk mund të shkruhet as në vija të përgjithshme në kolonat e një gazete, por mjafton të kujtojmë sakrificat e tij dhe përpjekjet e udhëtimet e kryera, e periodikët e themeluar dhe të drejtuar prej tij me kulturën dhe me zjarrin atdhetar të tij. Ai tashmë sheh të kurorëzuara përpjekjet e tij edhe me shpresën se atdheu do të bëhet shpejt më i madh dhe më i lulëzuar”<sup>4</sup>.

Ndërsa Atë Simon Rrota ishte shprehur: “Edhe sikur të mos kishte bërë tjetër për gjuhën kombëtare, ai me botimin e revistës Albania në kohë dhe rrethana mjaft të vështira, ka siguruar një vend mes të parëve në historinë e letërsisë shqipe.”<sup>5</sup> Më tej Petrota thekson se të dymbëdhjetë vitet e publikimit të “Albanias” mund të quhen enciklopedia shqiptare: histori, letërsi, gjuhësi, arkeologji, folklor, politikë, religjon, art, gjithçka është shtjelluar në të me profesionalizëm. Përmbledhja e krijimeve letrare më të rëndësishme, e përkthimeve nga vepra të huaja, e artikujve më të mirë politikë e historikë, e novelave, përrallave, poezive të kësaj reviste, do të përbënte një bibliotekë të pasur, të larmishme dhe të vlefshme shqiptare.

Publicisti i njohur arbëresh Anselmo Lorecchio dhe drejtuesi i një prej revistave më të njohura në historinë e shtypit arbëresh, “La Nazione Albanese”, do të shkruante në numrin e të datës 10 korrik 1919, se:

“Faik Konica, nuk ka njeri të mos e njohë, është shkrimtari i ditur që prej një çerek shekulli, - me ndihmën e gjuhëve të gjalla: shqipe, turke, italiane, gjermane, franceze, angleze dhe të gjuhëve të vdekura: latine dhe greke, të cilat i njëjta lirisht, është përthelluar në hulumtimin e gjithë asaj që jepet nga historia, onga filologjia, nga traditat, që të nxjerrë çka nevojitet për të rikthyer madhështinë e kombësisë shqiptare; ... dhe veç kësaj është drejtori luftarak i gazetave dhe i revistave që ai ka botuar nga Brukseli, nga Londra, nga Amerika, për të mbrojtur njësinë dhe pavarësinë e Shqipërisë.” (Petrota, G., 2008: 352).

---

<sup>4</sup> Po aty, fq. 349.

<sup>5</sup> Po aty.

Ashtu siç vlerëson edhe Petrota, Faik Konica do të ishte i pranishëm në mbrojtje të Shqipërisë aty ku duhet të ngriheshin avokatë ballë kombeve të tjera: në revista e gazeta, në takime politike, në kongrese letrare dhe shkencore, ai çonte fjalën e tij me peshë në mbrojtje të të drejtave të kombit të tij. Ai e ngriti çështjen shqiptare në një çështje europiane konkrete, qe kërkonte një zgjidhje të ngutshme sipas parimeve të kombësisë. Dhe po t'i referohemi përcaktimeve tënjë prej aturëve më të njohur për çështjet e kombësisë, Ernest Gellner: “grupet etnike dhe kombëtare, janë «shpikje», të krijuara në mënyrë të ndërgjegjshme në mjediset e ngushta të intelektualëve dhe të studiuesve entuziastë.”

Në përfundim dhe për sa parashtruam më sipër mund të themi se lidhja e “treshes” Erber-Konica-“Albania” në funksion të përfshirjes së historisë, traditave, vlerave dhe përpjekjeve të shqiptarëve në koloninë e Borgo Erizzos për të rindërtuar jetën e re në vendin e ri e për t’u përfshirë në jetën e tij pa humbur tiparet kombëtare, ishte në funksion të ndërtimit të drejtë të opinionit publik shqiptar dhe të huaj se shqiptarët janë faktor i rëndësishëm dhe konstruktiv në Ballkan dhe Europë. Ata kudo ku kanë emigruar kanë mbartur me vete vlera të larta morale dhe intelektuale, duke mbetur njëkohësisht të lidhur me historinë dhe kujtimet e vendit të origjinës, si një komb që duhet të gëzojë të drejtat e veta natyrore.

## **BIBLIOGRAFI:**

Boriçi, Hamit & Marku, Mark. (2010) *Historia e shtypit shqiptar. Nga fillimet deri në ditët tona*, SHBLU, Tiranë.

Dervishi, Nebi.: *Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës*, Revista “Studime Albanologjike”, Instituti i Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, fq.: 283-288.

Elsie, Robert (1997) *Histori e letërsisë shqiptare*, Përkthyer nga origjinali anglisht “History of Albanian Literature (1995)”, Tiranë.

Ferri, Naser. (2018) *Kujtimi i eksodit të dhimbshëm të arbëneshëve nga Shqipëria në Zarë*, “Gjurmime Albanologjike” - Seria e shkencave historike, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2018: 377-380.

*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Qendra e Enciklopedisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Goffman, Erving. (1959) “The Presentation of Self in Everyday Life”, Garden City, NY: Doubleday.

Kamsi, W. (2008) *Albania 1897-1909. Bibliografi kronologjike*, Biblioteka Françeskane “At -Gjergj Fishta”, Serija bibliografike, Bleni I, Shkodër.



Petrota, Gaetano. (2008) *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Palermo 1932, Botimet “Almera”, Tiranë.

Stipçeviq, Aleksandër. (2012) *Etnogjeneza e shqiptarëve nga Ilirët*, Revista “Studime Albanologjike”, Nr. 5, Shkup.

Stipçeviq, Aleksandër. (1991) *Albanologjia në Kroaci*, “Gjurmime Albanologjike”, Seria e Shkencave Histosrtike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 21/1991.

Shema, Isak. “Sinteze shkencore kushtuar kulturës tradicionale të arbëneshëve të Zarës”, ExLibris: <https://exlibris.al/sinteze-shkencore-kushtuar-kultures-tradicionale-te-arbenesheve-te-zares/>

#### **Artikujt referues në Revistën Albania:**

T. Erber, *Shcyptart e Borgo Erizzos* (I. T’ardhunit e pare n’vjete 1726), Vol.G,VI 1902, Nr. 3, fq. 51-53.

T. Erber, *Shcyptart e Borgo Erizzos* (I. T’ardhunit e pare n’vjete 1726), Vol.G,VI 1902, Nr. 4, fq. 75-77.

T. Erber, *Shcyptart e Borgo Erizzos* (II. Kanuni i Shcyptarve), Vol. G, VI/1904, Nr. 5, ff. 139-144.

T. Erber, *Shcyptart e Borgo Erizzos* (III. T’ardhunit e dyte n’vjete 1727), Vol.G,VI/1902, Nr.6, fq. 162-163.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (IV. Shcyptart deri n’vjete 1733), Vol. G, VI/1902, Nr.8, fq.194-195.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (V. T’ardhunit e trete n’vjete 1733), Vol.G,VI/1902, Nr.10, fq. 225-227.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (VI. Toke ci u kien dhanun Shvyptarve ci erdhën n’vjete 1733), Vol.H, VII/1903, Nr.4, fq. 50-51.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (VII. T’shcymun e t’bajtn shpiiash shcyptare), Vol. H, VII/1903, Nr.5, fq. 69-70.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (VIII. T’nertuemt e kishes), Vol. I, VIII/1904, Nr.2, fq. 27-28.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (IX. T’nnollunat e Shcyptarvet deri n’vjet 1759), X. T’parat sheje tregtiet e mjeshtriet n’Arbneshe, XI. Shtetesii e Arbneshve). - Vol. I, VIII/1904, Nr.5, fq. 89-92.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (XII. Katunnet e Shcypniis, preje t’tsilash u-bajte Shcyptaret e Arbneshvet). - Vol. I, VIII/1904, Nr.7, fq. 131-133.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (XIII. Shpia e vennse, XIV. Mjeshtrie e tregtie), Vol. I, VIII/1904, Nr.10, fq. 187-189.

T. Erber, *Shcyptart e Arbneshvet* (XV. Komsii e ghuhe), IX/1905, Nr.1, fq. 21-22.